



VENDIM PËR PAPANUESHMËRI

Data e miratimit: 20 mars 2012

Numri i lëndës 2011-19

Z. Sefer Sharku

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 20 mars 2012, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare
Znj. Verginia MICHEVA-RUSEVA, anëtare

Asistuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, dhe Rregulloren e Punës së Panelit të datës 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 25 maj 2011.

II. FAKTET

2. Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga parashtruesi i ankesës, dhe siç shihen prej dokumenteve që janë në dispozicion të Panelit, mund të përmbledhen si në vijim.

Pronësia fillestare mbi pronën

3. Në vitin 1955 vëllai i parashtruesit të ankesës nga ana e babait me iniciale Q.S. kishte hequr dorë nga e drejta e tij në trashëgimi në një ngastër kadastrale dhe një shtëpi që ishte ndërtuar në të në Rahovec. Kjo ishte vërtetuar nga Gjykata Komunale e Rahovecit më 28 dhjetor 1955. Që prej atëherë e deri së fundi prona i takonte parashtruesit të ankesës, dy vëllezërve dhe katër nipave të tij.
4. Në vitin 1995 parashtruesi i ankesës dhe vëllezërit e tij dëgjuan thashetheme se Q.S. mund të shes gjysmën e pronës duke shfrytëzuar dokumente të falsifikuara për të dëshmuar pronësinë e tij.
5. Në maj të vitit 1996, bazuar në kërkesën e parashtruesit të ankesës dhe vëllezërve të tij Gjykata Komunale e Rahovecit konstatoj se Q.S. kishte hequr dorë nga të drejtat e tij në trashëgimi në mënyrë ligjore në vitin 1955 dhe prandaj ai nuk ishte pronar i pronës. Gjykata kishte urdhëruar Administratën e Gjeodezisë të hiqte pronësinë e të dyshuarit nga regjistri mbi pronësi. Masa e përkohshme e marrë në vitin 1995 kishte mbetur në fuqi deri në përfundimin e kontestit. Paneli nuk ka njohuri nëse ky vendim ka marrë formën e prerë.

Kontesti rreth pronësisë së pronës

6. Në janar të vitit 2001 M.S. dhe të tjerët, të cilët pretenduan se kishin blerë gjysmën e pronës nga Q.S. në vitin 1995, kishin kërkuar nga Gjykata Komunale e Rahovecit që prona, përfshirë edhe shtëpinë, të ndahej për gjysmë.
7. Pasi nuk ishte arritur ndonjë marrëveshje midis palëve gjatë procedurës jo kontestuese, Gjykata Komunale e Rahovecit kishte detyruar M.S. të niste një procedurë civile brenda një afati kohor të caktuar për të mundësuar ndarjen e pronës (në tetor të vitit 2001).
8. Në shkurt të vitit 2005 Gjykata Komunale e Rahovecit kishte kundërshtoj prishjen e kontratës për shitje të vitit 1995 siç ishte kërkuar nga parashtruesi i ankesës, kështu përmes kësaj mënyre legalizohej prona e M.S. dhe të tjerëve, në kundërshtim me vendimin e mëhershëm gjyqësor të vitit 1996 (shih paragrafi 5 më lart). Paneli nuk është i njoftuar nëse ky vendim ka marrë formën e prerë.

Procedura për lirimin e pronës

9. Diku në muajin mars-prill 2011, M.S. dhe të tjerët kanë kërkuar që Gjykata Komunale e Rahovecit të urdhëronte parashtruesin e ankesës të liroj shtëpinë dhe të largonte prej aty të gjitha gjësendet e tij. Ata pohuan se parashtruesi i ankesës kishte filluar rrënimi i shtëpisë dhe ata kërkuan masë të përkohshme për ta penguar këtë veprim nga ana e tij. Paneli nuk është i njoftuar se çfarë ishte rezultati i këtyre seancave.
10. Më 21 mars 2011, parashtruesi i ankesës kërkoj që Drejtoria për Urbanizim, Planifikim dhe Mbrojtje Mjedisore (më tutje: "Drejtoria") në Rahovec, mos t'i jepte M.S. dhe të tjerëve leje për rrënimin e shtëpisë

në kontest dhe që mos t'i jepte leje për ndërtim në ngastrën në fjalë. Kërkesa e tij ishte hedhur poshtë më 26 prill 2011. Drejtoria deklaroi se vendimi administrativ ishte bazuar në faktet e parashtruara dhe se Drejtoria nuk ka kompetencë të merr ndonjë vendim lidhur me kontestin civil.

11. Më 19 prill 2011, parashtruesi i ankesës kishte bërë një kërkesë tek gjykatësit e EULEX-it t'i përjashtoj gjykatësit e Kosovës nga lënda, pasi dyshohej se familja e M.S. kishte ndikim mbi ta. Kjo kërkesë ishte hedhur poshtë më 29 prill 2011 nga Gjykata Komunale e Rahovecit.
12. Më 21 prill 2011, parashtruesi i ankesës paraqiti një kërkesë të re tek Kuvendi Komunal i Rahovecit që mos t'i lëshonte leje M.S. q të shembte shtëpinë. Kjo kërkesë ishte hedhur poshtë më 26 prill 2011 atëherë kur Kuvendi Komunal kishte deklaruar se familja e M.S. ishte pronar i ligjshëm i shtëpisë.
13. Më 13 maj 2011, parashtruesi i ankesës kishte kërkuar masë të përkohshme nga Gjykata Komunale e Rahovecit për të penguar shembjen e shtëpisë. Asnjë veprim nuk ishte ndërmarrë lidhur me këtë kërkesë. Sipas parashtruesit të ankesë shtëpia ishte rrënuar po atë ditë.
14. Më 16 maj 2011, parashtruesi i ankesës kontaktoj EULEX-in në Prizren rreth faktit se ai më herët kishte kërkuar një masë të përkohshme dhe kishte kërkuar që EULEX-i të merrte përsipër hetimin e lëndës së parashtruesit të ankesës, mirëpo asgjë nuk ishte ndërmarrë. Ai pohon se lidhur me këtë rast nuk është pranuar ndonjë përgjigje nga EULEX-i.

III. ANKESAT

15. Parashtruesi i ankesës pretendon se ka pasur shkelje të Nenit 6 (e drejta për gjykim të drejtë) e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (Konventa) dhe Nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës (e drejta për gëzim paqësor të pronës). Ai kërkon nga EULEX-i të ndërmerr masa për të ndalur çfarëdo veprimi në pronë deri në marrjen e një vendimi nga Gjykata Supreme. Gjithashtu ai kërkon që hetimi i lëndës të merrej përsipër nga EULEX-i për shkak të dyshimit se ka njëanshmëri në Gjykatën Komunale të Rahovecit.

IV. LIGJI

16. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së Punës.

17. Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, siç përcaktohen në Rregullën 25, paragrafin 1 të Rregullores së vet të Punës.
18. Sipas Rregullës së përmendur më lart, bazuar në konceptin llogaridhënës në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave në Kosovë.
19. Paneli vëren se parashtruesi i ankesës në thelb kërkon që Paneli të konstatoj se ka shkelje, pasi që EULEX-i nuk ka ndërmarrë asnjë masë të përkohshme lidhur me pronën e tij, përderisa lënda shqyrtohet nga Gjykata Supreme të Kosovës.
20. Mandati i EULEX-it nuk e autorizon atë që të ndërmerr masa të tilla, të cilat janë kompetencë vetëm e gjykatave të Kosovës. Prandaj çështja që është ngritur nga parashtruesi i ankesës nuk bie në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë.
21. Për më tepër, Paneli konstaton se çfarëdo ankese lidhur me njëanshmëri të dyshuar në punën e ndonjë gjykate në Kosovë mund të ngritet si bazë për tu ankimuar në procedura të rregullta për ankimim. Sidoqoftë, në këtë rast, për aq sa ajo ka të bëjë me mandatin ekzekutiv të EULEX-it, Paneli konstaton se EULEX-i nuk ka mandat që të veprojnë si gjykatë e apelit brenda sistemit gjyqësor të Kosovës.
22. Prandaj, këto çështje që ngritën në këtë lëndë nuk hyjnë në kuadër të mandatit të Panelit, ashtu siç saktësohet në Rregullën 25 të Rregullores së vet të Punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë.

PËR KËTO ARSYE, Paneli njëzëri,

konstaton se nuk ka kompetencë për të shqyrtuar këtë ankesë,

gjen se sipas Nenit 29 (d) të Rregullores së vet të Punës, ankesa është e pabazuar, dhe

SHPLL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Antonio BALSAMO
Kryesues i Panelit